



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Naser Fejzullahu	14.11.2023	06.12.2023	2023/0897
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Zenel Hisenaj	23.11.2023		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me Datën: 22.11.2023, " **Virtual Assistants** " **SH.A.** ka parashtruar ankesë me **Nr: 0897/2023** , kundër Njoftim Vendimit mbi dhënien të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me pajisje për krijimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe për arsimin special** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **MINISTRIA E ARSIMIT**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura t? hapur, lloji i kontratës: **Furnizime, vlera** e parashikuar e kontratës: **100.000.00 € vlere e madhe.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë **01.08.2023**, data e hapjes së ofertës **13.09.2023**, data e njoftimit për Dhënin e ofertës të Aktivitetit të Prokurimit **ka qene 26.10.2023.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënie të Kontratës.

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrUOPP-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre vite të fundit financiare duhet të jetë jo më pak se 2,000.000.00 Euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtarë financiare që dëshmon qarkullimin për tri vitet e fundit financiare (deklaratat vjetore të audituara) kopje .

Kapaciteti teknik dhe profesional

Operatori ekonomik duhet të ketë së paku 5 vite eksperiencë në implementimin e zgjidhjeve softuerike.

Operatori Ekonomik duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e projekteve për institucionet arsimore.

Kërkohet që operatori ekonomik të ketë përvojë në zbatimin e sistemeve të raportimit,

Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se posedon ekspertë të kualifikuar me përgatitje shkollorë dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe në veçanti të personave që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve.

5a. Menaxheri i projektit duhet të jetë i diplomuar në shkencë kompjuterike dhe Ose inxhinieri softuerike;

- Përvojë pune në projekte që janë të ndërtuara në teknologji për web aplikacione me kompleksitete të mëdha si ne fushën e (arsimit, financave publike apo te ngjashme);
- Të jetë i certifikuar në Project Management nga PMI Ose Ekuivalten..
- Të ketë së paku 5 vite përvojë, dhe atë të ketë menaxhuar projekte në fushën e arsimit.

5b. Menaxher teknik të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Shkencave Kompjuterike – minimumi tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar me minimumin një (1) certifikatë te njohur ndërkombëtare në fushën e databazave dhe një (1) certifikatë te njohur ndërkombëtare në fushën e cloud.

5c. Një ekspert këshillues të projektit për temat e sigurisë së rrjetit dhe shkëmbimit të informacionit me eksperiencë në projekte te ngjashme Qeveritare.

5d. Një ekspert këshillues të projektit për temat financiare.

5e. Një ekspert këshillues të projektit për temat juridike.

5f. Një Analist biznesi

- Përvojë pune në projekte që janë të ndërtuara në teknologji për web aplikacione dhe aplikacione me kompleksitet te mëdha si ne fushën (mjekesise, financave publike apo te ngjashme);
- Të jetë i diplomuar në shkenca kompjuterike dhe ose inxhinieri softuerike.

5h. Një Ekspert për Kontrollë te Cilësisë

- Përvojë pune në projekte që janë të ndërtuara në teknologji për web aplikacione me kompleksitete te mëdha;
- Të jetë i diplomuar në ndonjërin nga fushat e inxhinierisë;
- Të jetë i e certifikuar në Software Quality Assurance nga një institucion i akredituar.

6. Staf të mjaftueshëm për ofrimin e përkrahjes teknike përmes telefonit dhe email në kohë 24 orë në 7 ditë (24 7).

7. Operatori ekonomik duhet të posedojë hapësirë – sallë totale minimumin 200 m², me të gjitha pajisjet e nevojshme për mbajtjen e trajnimeve të stafit për këtë modul.

8. Operatori Ekonomik duhet të ketë kapacitete për përfundimin e projektit brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë pune.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Dokumentet e rexhistrimit të biznesit, në të cilat dëshmohet eksperiencia e kompanisë.

Dëshmia 3. Një listë të kontratave të nënshkruar dhe vulosur, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.

Dëshmia 4. Lista e projekteve (raport pranimi ose referencë nga autoriteti kontraktues).

Dëshmia 5: Listën e eksperteve që do të angazhohen.

Dëshmia 5 a:

- Vendimin për cilësinë e angazhimit
- CV e ekspertit të nënshkruar;
- Letër-referencë nga punëdhënësi;
- Kopja e noterizuar e diplomës universitare;
- Kopja e noterizuar e certifikatës ose mundësia e verifikimit online.

Dëshmia 5b:

- Vendimin për cilësinë e angazhimit
- CV e ekspertit të nënshkruar;
- Letër-referencë nga punëdhënësi;
- Kopja e noterizuar e diplomës universitare;
- Kopja e noterizuar e certifikatës ose mundësia e verifikimit online.

Dëshmia 5c:

- Vendimin për cilësinë e angazhimit
- CV e ekspertit të nënshkruar;
- Letër-referencë nga punëdhënësi;
- Kopja e noterizuar e diplomës universitare;
- Kopja e noterizuar e certifikatës ose mundësia e verifikimit online.

Dëshmia 5d:

- Vendimin për cilësinë e angazhimit

- CV e ekspertit e nënshkruar;
- Letër-referencë nga punëdhënësi;
- Kopja e noterizuar e diplomës universitare;

Dëshmia 5e:

- Vendimin për cilësinë e angazhimit
- CV e ekspertit e nënshkruar;
- Letër-referencë nga punëdhënësi;
- Kopja e noterizuar e diplomës universitare;

Dëshmia 5f:

- Vendimin për cilësinë e angazhimit
- CV e ekspertit e nënshkruar;
- Letër-referencë nga punëdhënësi;
- Kopja e noterizuar e diplomës universitare;
- Kopja e noterizuar e certifikatës ose mundësia e verifikimit online.

Dëshmia 5h:

- Vendimin për cilësinë e angazhimit
- CV e ekspertit e nënshkruar;
- Letër-referencë nga punëdhënësi;
- Kopja e noterizuar e diplomës universitare;
- Kopja e noterizuar e certifikatës ose mundësia e verifikimit online.

Dëshmia 6:

CV e nënshkruar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar),

Dëshmia 7:

OE, duhet të dëshmojë se posedon sallën për mbajtjen e trajnimeve në pronësinë e saj, ose marrëveshje për shfrytëzimin e sallës, me të gjitha paisjet përcjellëse.

Dëshmia 8 - Një plan të detajuar për realizimin e projekti në fjalë i nënshkruar dhe vulosur

nga Operatori Ekonomik.

Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**apo

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni për vlerësim të ofertave i përbërë prej tre anëtarëve, ka analizuar me hollësi të gjithë dokumentacionin duke iu përmbajtur kritereve të kërkuara në dosjen e tenderit, vije në përfundim se kompania fituese shpallet: Grup i Operatorëve Ekonomik SPECTRA ING SH.P.K.; TECH VISION SH.P.K.: çmimi për njësi 560.15€

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Po, por ka thënë se nuk është për Ekspert teknik nuk ka pike që nderlidhet me aspektin profesional të IT-se.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Ka interes juridiko material.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - "Virtual Assistants" SH.A.

Pretendimi 1

(Skjarim për pikën 1): Pra të zhvillohet/programohet nga fillimi një softuer i ri “Text-to-Speech” përmes DL, NLP, AI që janë teknologjitë më të avancuara mbrenda 30 dite ashtu siq ka premtuar GOE është e pamundur pasi që vetëm trainimi i kompjuterit/makines kërkon 3-5 muaj me i mësu fjalët shqipë dhe megjithëatë është rekomanduar nga AK.

Përgjigjeje ne pretendimin 1

Sa i përket këtij pretendimi mendoj se ky projekt nuk mundet të kryhet brenda 30 ditëve si që ka qene kriteri i vlerësimit ne dosjen e tenderit dhe asnjëra kompani që kane konkurruar nuk e plotësojnë këtë kriter.

Gjithashtu kriteri i vlerësimit i kërkuar ne dosjen e tenderit nga AK-ja është shume konfuze dhe nuk është ne pajtueshmëri me kërkesat e specifikimeve që kërkohej me u realizuar projekti ne fjale.

Ky pretendime është i bazuar por as kompania ankues nuk mundet të e realizoj këtë brenda 30 ditëve nje projekt me vlere te buxhetit 1,000.000.00€.

Pretendimi 2

(Skjarimi për pikën 2): Për ta bërë Lokalizimin/Përkthimin në gjuhën Shqipe të sistemit për leximin e ekranit JAWS e cila është brand i kompanisë Amerikane Freedom Scientific (për të cilën Ambasada Amerikane në Prishtinë si përfaqësues legjitim i kompanive të USA është e informuar për këtë proces) dhe Integrimi i Sintezes TTS që duhet të zhvillohet sipas pikës një (1) më lart është e pamundur nëse nuk je Partner/Distributor i kësaj kompanie (Freedom Scientific, si brend i VISPERO) e ku GOE e rekomanduar NUK është dhe me këtë edhe nuk do mund ta realizon këtë pikë sipas kërkesës në DT, dhe megjithatë është rekomanduar nga AK. Për ta dëshmuar këtë dhe lehtësuar verifikimin po e paraqesim dëshmin nga uebfaqja e Freedom Scientific publikimin për kompaninë tonë Virtual Assistants Group si përfaqësues zyrtar i tyre për Kosovës, Maqedoni dhe Shqipëri:

Në web-faqen e kompanisë “Freedom Scientific”, shihet se jemi te vetmit në Republikën e Kosovës që kemi autorizime për përfaqësim nga kjo kompani (për Kosovë, Maqedoni Veriore dhe Shqipëri

Përgjigjeje ne pretendimin 2 dhe 3

Sa i përket këtij pretendimi AK-ja nuk ka kërkuar autorizim dhe është shume konfuze pse nuk është kërkuar autorizim nga prodhuesi i makinave nga AK-ja pasi janë pajisje që kushtojnë dhe që janë specifike që duhet mi sofwerin me pas. Ne kete pasi nuk është kërkuar autorizim nuk ka pasur arsye të jete partner i ndonjë prodhuesi dhe për këtë pretendim është i pa bazuar mirëpo për ekspertin është shume konfuze tani edhe garacioni që është kërkuar nga prodhuesi e a do të ofrohet ne të ardhmen ne realizimin e kontratës.

Ne dosjen e tenderit Aneksi 1 specifikim teknik është kërkuar të tabel 8 “Lista e kërkesave në lidhje me garancinë, mbështetjen dhe mirëmbajtjen” pika 2 është kërkuar “Kompania duhet të ofroj përditësim të sistemeve softuerike të kërkuara për një periudhë kohore prej 10 vjetëve, me që rast përditësimet janë të rregullta së paku një herë në vit” gjithashtu edhe të pika 3 “Kompania zhvillues duhet të ofroj përkrahje teknike në lidhje me instalimin,

përdorimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve për një periudhë 10 vjeçare për së paku 40 orë në javë, për çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në 16:00, përmes një linje telefonike të dedikuar vetëm për sistemet e kërkuara ' ne baze te saj është shume konfuze realizimi i kontratës me vlere njeri OE ankues ka ofruar çmim 200.000.00 € ndërsa OE fitues ka ofruar 299.00€.

Sipas ekspertit mendoj se specifikimi teknik ka qene i qarte nga njësia e kërkesës dhe duhet te jete me i gjere te këtë me shume hapësirë për konkurrencën dhe ne përputhje me LPP-ne . Këtu zyra e prokurimit nuk e ka kërkuar autorizimin e prodhuesit ka dash me jep hapësirës me shume OE tjerë me ofertuar dhe këtë unë mendoj se ka mos marrëveshje ne mes njësisë se kërkesës se Ministrisë se Arsimit dhe zyrës se Prokurimit.

Ne baze te deklarimit te vete kompanisë ankues qe e cek se jemi te vetmit qe kemi autorizim qe kemi përfaqësim mundem me konkluduar se kërkesat e dosjes se tenderit nuk kane qene te qarta për te gjithë OE.

Pretendimi 3

(Skjarimi për pikën 4): Të zhvillohet dhe integrohet sistemi alfabetit Braille Shqip në sistemin JAWS e cila ju mundëson që përdoruesit e Verbër ta lexojnë tekstin e shkruar në Ekran Braille (Braille Display) dhe kjo është pika e radhës e cila nuk mund të integrohet as zhvillohet nëse kompania nuk është Partnere/Distributor i kompanis Freedom Scientific (pron e kompanis VISPERO), dhe megjithatë AK e ka rekomanduar një GOE e cila nuk është as partnere e as distributor për Freedom Scoentific.

Ajo qfar na bën për të dyshuar shumë se GOE Tech Vision dhe Spectra Ing nuk e kan as iden se në qfar Tenderi kan apliku është se në “Deklaratë Mbi Planin Dinamik” ata shkruajnë citim: “Instalimi dhe konfigurimi i makinës (softuerit)” dhe që të ler me kuptuar qart se ata nuk e kan iden se dy (2) sisteme kan mu zhvillu nga fillimi dhe dy (2) sisteme kan me u përkthye komplet në gjuhën Shqipe ashtu siq kemi shpejguar më lart dhe megjithatë AK e ka rekomanduar.

Si dëshmi shihni atë cfar GOE ka ofruar në “Deklaratë Mbi Planin Dinamik” :

Përgjigjja ne pretendimin 3

Sa i përket këtij këtij pretendimi ankimor ne mendojmë si ekspert se nuk mundet te instalohet dhe te integrohet një sistem i alfabetit brenda 30 ditëve sa është kërkuar me u realizuar si kriter i vlerësimit dhe mendoj si pretendim është i bazuar. Mirëpo ne baze te kriterit te kërkuar ne dosjen e tenderit: [Operatori Ekonomik duhet të ketë kapacitete për përfundimin e projektit brenda afatit prej tridhjetë \(30\) ditë pune](#) – as ju si OE ankues nuk e përmbushni kushtin e kërkuar te dosjes se tenderi qe i bije se te dy OE janë te pa përgjegjshëm.

Pretendimi 4

Kompania ankues ka cekur ne kete pretendim se nuk mundet te realizohet ky projekt me kete çmim me nje vlere totale prej 560.15€ çmimi i poentuar ndërsa i pa poentuar 931.00€.

Ne pozicionin 1 kanë dhënë çmimin prej 299 €, ndërsa zhvillimi i këtij softverit e cila është një makine (motor-engine) për përpunimin e tekstit dhe shndërrimin e tij në të folur (ne zë), pra ky softuer për tu zhvilluar sipas kostove të tregut është mbi dyqind mijë euro dhe që te jetë funksional kërkohet integrimi i tij me softuerin e lexuesit të ekranit JAWS (screen Reader), e cila shitet nga kompania e vetme e cila është amerikane me emrin Freedom Scientific, dhe vetëm një licencë e tij kushton 1470 dollarë që mund ta gjeni në linkun:

<https://www.freedomscientific.com/products/software/jaws/>, i cili produkt është kërkuar nga vet AK.

Përgjigje ne pretendimin 4

Eksperti shqyrtues ka bërë një hulumtim në internet për Makina për leximin e tekstit me zë sinteza vokale (text -tu-speech) që është kërkuar në përshkrimin të çmimit të artikulli 1 del se një makinë kushton 2000.00 € deri 2,400.00 që në bazë të kësaj vërtetohet se nuk mundet të realizohet kjo kontratë në të ardhmen kompania që është rekomanduar nuk ka mundësi të realizuar me atë çmim. AK-ja gjatë fazës së vlerësimit të ofertave në bazë të ligjit ka mundur të sqarojë me pyetje sqaruese lidhur me këtë artikull . Çmimet që ka ofruar OE i rekomanduar dhe çmimet që i ka ofertuar OE ankues, janë diametralisht larg njëra tjetrës që kështu mundem të konkluduar se specifikimi teknik nuk ka qenë mjaft i qartë ose ju është përshtat specifikimi teknik pasi kompania ankuese ka ofruar ofertën vetëm 1 euro ndër buxhet .

Pretendimi 5

Të kërkesa e AK mbi mundësit teknike dhe profesionale (DT :9.1 &9 9.2 – NJK: Neni III.2.4), është kërkuar që OE duhet të ketë përvojë në zhvillimin e dhe implementimin e të paktën 1 (një) projekti për institucionet arsimore, ndërsa GOE i rekomanduar për kontratë, sipas Listës së Kontratave dhe Referencave të paraqitura në tenderim nga Tech Vision3, të njëjti nuk kanë realizuar asnjë projekt në institucionet arsimore4, ashtu siç është kërkuar nga AK.

Përgjigje ne pretendim 5

Sa i përket këtij pretendimi eksperti shqyrtues mendon se kompania e rekomanduar nuk ka referencë dhe përvojë në zhvillimin dhe implementimin e projekteve për institucionet arsimore, ndërsa në bazë të listës së referencave që ka dorëzuar kompania e rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues konstaton se ka dëshmi për referencat të ngjashme që për ekspertin shqyrtues mundën me qenë të pranueshme, por kriteri në dosjen e tenderit është kërkuar **nga institucionet arsimore** që i bijnë që ka qenë kriter kufizues .

Në bazë të kriterit të dosjes së tenderit pretendimi ankues është i bazuar.

Pretendimi 6

Të kërkesa e AK mbi mundësit teknike dhe profesionale (DT :9.1 &9 9.2, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se posedon ekspertë të kualifikuar me përgatitje shkollë dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe në veçanti të personave që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve.

Përgjigjeje ne pretendimin 5

Kompania e rekomanduar ka dorëzuar listën e stafit që done të angazhohet në këtë projekt mirëpo eksperti konstaton se kompania e rekomanduar për kontratë ka ofruar deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese. Në mesin e listës së stafit që kanë dorëzuar nuk janë punëtor të kompanisë fituese dhe pa dijeninë e tyre i kanë futur dokumentet dhe certifikatat (për këtë komisioni i vlerësimit është dashur të vërtetoj) dhe ka lëshuar vendim se është i angazhuar të kompania fituese që në bazë të kësaj vendimin që kanë lëshuar përmban informata të gabueshme ose mashtruese.

Ky pretendim është i bazuar

Përgjigje ne pretendim e nenit 7

Shkelje e Nenit 7, Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi. Autoriteti kontraktues me rastin e shpalljes së Njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka vendosur kritere diskriminuese, duke u bazuar në këto të cekura me lartë mendojmë se kriteret janë kërkuar në maksimumin e mundshëm dhe kjo shifet se është bërë kufizim i konkurrencës pasi vetëm një OE i ka plotësuar kriterin e dosjes së tenderit, që të përgatiten kritere sa më profesional për të ushtruar veprimtarinë profesionale për ofrimin e shërbimeve të natyrës së njëjtë si që ka kërkuar AK.

Rekomandim -Info për panelin e OSHP-se.

Në bazë të kësaj eksperti shqyrtues mendon se AK-ja ka tejkaluar limitet e përcaktuar me ligj dhe rregullore dhe duhet të bëjë rivlerësimin e ofertave dhe të anulohet aktiviteti i prokurimit pasi probabiliteti i përshtatjes së kriterëve, mos vlerësimi profesional, dis-ballansimi i çmimeve që ekziston në këtë aktivitet të prokurimit dhe buxheti që është përshtat konsiderohet i madh për përshtatje të kriterëve nga AK-ja. Arsyeja pse po e kërkoj këtë është se AK duhet ta bëjë njëherë ri-vlerësimin e ofertave nga një komision tjetër me përputhje me ligj dhe tani të anulohet aktiviteti.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Virtual Assistants" SH.A., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me pajisje për krijimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe për arsimin special" me numër të prokurimit: "208 Udheheqesi-23-8065-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E ARSIMIT

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E ARSIMIT**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" Virtual Assistants " SH.A.**

Naser Fejzullahu



Zenel Hisenaj

